



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.357/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), Ramush Bardiqi – kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ndaj vendimit Nr.01/3018-2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare, të Zgjedhjeve Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 29.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa ZL.Anr.357/2025, e datës 27.10.2025, e parashtruar nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ndaj vendimit Nr.01/3018-2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare, të Zgjedhjeve Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

PZAP-i më datë 27.10.2025, ka pranuar ankesën ZL.Anr.357/2025, paraqitur nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ndaj vendimit Nr.01/3018-2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare, në të cilën pretendon se në Komunën e Hanit të Elezit është vërejtur një numër i madh i votimeve me asistencë, nga gjithsej 5,015 vota të vlefshme, 665 vota evidentohen me asistencë apo 13.26%. Derisa dallimi mes kandidatit të parë, fitues i garës zgjedhore pa balotazh dhe kandidatit të dytë është vetëm 134 vota, atëherë del se numri i votave me asistencë është 5 herë më i madh se dallimi i votave (134) mes dy kandidateve në garë. Kanë theksuar se gjendja konkrete në vendvotimet e Hanit të Elezit, në lidhje me votimin me asistencë, e nxjerrë nga librat e votimit është si vijon: në VV 3301/01, nga 536 vota, 65 me asistencë, apo 12.13%, në VV 3301/02, nga 543 vota, 78 me asistencë, apo 14.36%, në VV 3301/03, nga 539 vota, 48 me asistencë, apo 08.90%, në VV 3301/04, nga 528 vota, 67 me asistencë, apo 12.69%, në VV 3302/01, nga 523 vota, 28 me asistencë, apo 05.35%, në VV 3302/02, nga 474 vota, 61 me asistencë, apo 12.87%, në VV 3303/01, nga 359 vota, 69 me asistencë, apo 19.22%, në VV 3303/02, nga 294 vota, 43 me asistencë, apo 14.62%, në VV 3304/01, nga 315 vota, 59 me asistencë, apo 18.73%, në VV 3304/02, nga 521 vota, 72 me asistencë, apo 13.82%, në VV 3304/03, nga 383 vota, 75 me asistencë, apo 19.58%, përqindja e votave me asistencë arrin në 13.26% të të gjitha votave të vlefshme, e që shihet në librat e

votimit se votimi me asistencë në mbi 90% të rasteve është asistuar mbi arsyet se votuesi “*nuk she*” dhe “*nuk din*”. Kjo paraqet një devijim të vullnetit politik, dhe një kërkesë e drejtpërdrejt që ë hetohen të gjitha rastet e votimit me asistencë në të gjitha vendvotimet. Tutje kanë shtuar se nga statistikatat zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, si dhe Departamenti për Pensione të Ministrisë së Financave, në komunën e Hanit të Elezit është regjistruar vetëm një person i verbër. Një numër jo i madh, pra dikun rreth 10 persona janë me të pamur të dobësuar, afër verbërisë, por në asnjë rrethanë nuk janë mbi 240 persona të verbër apo me të pamur të dobësuar siç vërehet nga librat e votimit në dispozicion. Tutje kanë shtuar se një numër i madh i votimeve me asistencë nuk është shënjuar asnjë arsyetim, që është në kundërshtim me ligjin dhe rregulloren. Kanë kërkuar nga PZAP që ta anuloi pjesërisht vendimin e KQZ-së Nr.01/3018-2025 të datës 25.10.2025, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës për Kryetar Komune, të mbajtura më 12 tetor 2025. Të urdhëroj KQZ-në për rivotim në të gjitha vendvotimet, të përcjellë në Prokurori të gjitha rastet me elemente të veprës penale sipas ligjeve në fuqi dhe të shqiptoj sanksionet e parapara që bien në kompetencat e PZAP për shqiptimin e gjobave.

Pala ankuese kërkon nga PZAP të anuloi pjesërisht Vendimin e KOZ Nr. 01/ 3018 - 2025 , të datës 25.10.2025, Për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës për Kryetar Komune, të mbajtura më 12 tetor 2025, urdhëroj KQZ-në për rivotim në të gjitha Vendvotimet e cekura në këtë Ankesë: të përcjellë në Prokurorinë e Shtetit të Republikës së Kosovës të gjitha rastet me elemente të veprës penale, të shqiptojë sanksionet e parapara që bien në kompetencat e PZAP për shqiptimin e gjobave.

Në përgjigjen në ankesë të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese kanë theksuar se bazuar në nenin 89 paragrafi 5 dhe 6 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren Zgjedhore Nr.12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, sipas nenit 10, paragrafët 5, 6, 7 dhe 8, si dhe Procedura e Votimit dhe Numërimit në Vendvotim e miratuar nga KQZ me datën 12.08.2025, Nr.01/2051/2025, përcaktohet procesi i votimit me asistencë. Po ashtu kanë theksuar se nuk është raportuar për ndonjë parregullsi në dhomën operative të KQZ-së në ditën e zgjedhjeve, me datën 12.10.2025. Po ashtu i tërë materiali zgjedhor duke përfshirë kamerat e sigurisë, Librat e Votimit dhe Formularët gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), ku të njëjtat mund të verifikohen dhe të hetohen nga PZAP dhe organet e drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pas vlerësimit të afatshëm të ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme.

Paneli, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka gjetur se ankesa e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se ka numër të madh të votave me asistencë në vendvotimet në komunën e Hanit të Elezit, se përqindja e votave me asistencë në komunën e Hanit të Elezit ka ndikuar drejtpërdrejt në përjashtimin e kandidatëve të tjerë nga

gara demokratike, duke arrit rezultate që sigurojnë fitoren pa balotazh, dhe se përqindja e votave me asistencë në komunën e Hanit të Elezit arrin në 13.26%, nga gjithsej 5,015 vota të vlefshme, me arsyetimin në mbi 90% të rasteve votuesi/ja “nuk sheh” dhe “nuk din” pas mbylljes së vendvotimit lidhur me asistim të votimit, është e parashtruar pas afatit të përcaktuar ligjor.

Paneli vlerësoj se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 119, paragrafi 1 LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesës është afati 48 orë nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe se ankesa është dorëzuar më datë 27.10.2025, e në anën tjetër parregullsia për të cilin pretendon pala ankuese është bërë me datën 12.10.2025, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Me dispozitën ligjore të nenit 119 paragrafi 1 i LZP-së, i cili përcakton se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP-i, vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj”,* si dhe neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, i cili përcakton se *“PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim: 3.2. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor”.*

Neni 102 paragrafi 1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës përcakton se *“çdo anëtar i komisionit të vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin e tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje të Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në përputhje me këtë ligj”,* sipas nenit 11 paragrafi 4 të Rregullores Nr.11/2024, për Këshillat e Vendvotimeve, i cili nën përcakton se: *“Çdo anëtar i KVV, ka të drejtë të shënojë në librin e votimit vërejtje apo komente për rrjedhën e procesit në VV, apo të parashtojë ankesë në PZAP.*

Bazuar në dispozitat e lartcekura, Paneli pas analizimit të shkresave të lëndës ka gjetur se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 119, paragrafi 1 LZP-së, dhe neni 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.18 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, afati për dorëzimin e ankesës është brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, kjo pasi që ankesa është dorëzuar në PZAP, përkatësisht më datë 27.10.2025, ndërsa parregullsia për të cilin pretendon pala ankuese lidhet me procesit zgjedhor i cili është mbyllur më datën 12.10.2025 në ora 19.00, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Pretendimet e tjera të parashtruesit të ankesave PZAP nuk i ka shqyrtuar, sepse fillimisht ankesa ekzaminohet në drejtim të lejueshmërisë dhe afatshmërisë dhe nëse rezulton se është e palejueshme apo e pasafatshme, Paneli e hedh poshtë pa u lëshuar në përmbajtje e ankesave dhe pretendimeve ankimore sikurse në rastin konkret. Të gjitha deklaratimet dhe pretendimet e subjektit ankues edhe sikur të qëndronin apo të merreshin të mirëqena nuk mund të shqyrtohen

dhe ekzaminohen meqenëse aspekti i afatshmërisë është veprim paraprak i cili nuk ka mundësi të anashkalohet.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 119 paragrafi 1, nenit 115 paragrafi 1, nenit 102 paragrafi 1 i LZP-së Nr.08/L-228, dhe nenit 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3 të Rregullores 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.357/2025, datë 29.10.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.